



NJOFTIM PËR TË GJITHË KREDITORËT DHE PRONARËT E NDËRMARRJES

PRN098 NSh Mekanizimi

Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:

Drustveno Trgovinsko Preduzece Mehanizacija Fi.614/89

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij ligji, **NJOFTOHENI** se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar me datë 23 Qershor 2014 në bazë të vendimit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 7 Maj 2014.

Çdo person i cili pretendon se ka të drejtë kërkesë dhe/apo interesi ndaj kësaj ndërmarrjeje apo aseti të ndërmarrjes **duhet të parashtroj Dëshminë e Kërkesës përkatësisht Dëshminë e Interesit sipas nenit 7 në pajtim me nenin 23 të Shtojcës të Ligjit për AKP-në duke filluar prej datës 30 Qershor 2014 deri me datë 13 Gusht 2014 deri në orën 16:00.**

Nëse dështoni ta parashtroji Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit brenda afatit të lartë cekur, pretendimet e juaja do të konsiderohen si të pasafatshme, si dhe mos bashkëngjitja e dokumentacionit mbështetës kërkesës tuaj apo mos plotësimi i rregullt i formularëve, do të rezultojë që pretendimet e juaja do të konsiderohen si të papranueshme.

Formularët për Dëshminë e Kërkesës si dhe Dëshminë e Interesit mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së dhe duhet të dorëzohen në Zyrën Qendrore të AKP-së çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në ora 14:00 në adresën si më poshtë. Formularët e dorëzuar përmes postës elektronike nuk do të pranohen.

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Ilir Konushevc, nr. 08

Prishtinë, 10 000

Telefoni: +381 38 500 400

Fax: +381 38 248 076

Formularët për parashtrim të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit gjithashtu mund të shkarkohen edhe nga faqja e internetit të AKP-së në adresën www.pak-ks.org.

Për detaje se si të plotësohen dhe dorëzohen këta formularë shih **“Formularët-Udhëzime për plotësim”**.